



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 04.12.2012, miratoi këtë

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIEN E BANESAVE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS NË SHFRYTËZIM ME QIRA PËR ANËTARËT E FAMILJEVE TË DËSHMORËVE, INVALIDËVE DHE VETERANËVE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për dhënie e banesave në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteraneve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës, 01. nr. 360 – 2803, të dt. 6.12.2011.

II.

Neni 5, ndryshohen dhe plotësohet duke u riformuluar si në vijim:

“Të drejtë aplikimi për marrjen me qira të banesës së Komuna së Prishtinës, ka individ ose familja, që dëshmojnë se janë banorë të komunës së Prishtinës së paku 10 vite para kohës së aplikimit”.

III.

Në nenin 6, paragrafi 6.2, pika e shlyhet.

IV.

Në nenin 7, pika a, shlyhet, kurse te pika g, fjala kandidat shlyhet.

V.

Në nenin 10, paragrafit 10.2, fjalët “për secilin rast në veçanti”, zëvendoshet me fjalët “për secilin rast veç e veç”.

VI.

Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë vendim, gjejnë zbatim ligjet për zgjidhjen e çështjes së banimit, si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 - 44613, më 04.12.2012

**KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.**